

Të Jesh në Gjendje të Respektosh Një Jo

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Respekti, Përgjegjësia, Mirëkuptimi, Vetëbesimi, Sinqeriteti

Qëllimet

Pedagogjike: Të kuptohet si të bëhesh i respektueshëm dhe të respektosh të tjerët, të reagosh ndaj sulmeve mbi integritetin fizik ose psikologjik dhe të jesh në gjendje të thuash Jo.

Praktike: Leximi I historisë dhe zbulimi I dilemave me të cilat përballen personazhet.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 6 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

45 deri 60 minuta

Materialet

Fleta e aktivitetit që mund të projektohet ose t'i shpërndahet secilit nxënës e printuar.

Përmbledhje

Mësuesi/ja projekton ose i shpërndan fletën e aktivitetit secilit nxënës. Në grupe me dy veta nxënësit duhet t'u përgjigjen pyetjeve të dhëna. Në fund, çdo grup i prezanton përgjigjet klasës, ndërkohë që mësuesi/ja mund të shkruajë në dërrasë përfundimet kryesore.

Shënim

Në vend të leximit të ngjarjes, mësuesi/ja mund t'u kërkojë dy nxënësve që ta interpretojnë atë.

Për mbështetje dokumentuese rreth Dhunës në Marrëdhëniet intime sugjerohet të vizitoni

<https://www.cdc.gov/violenceprevention/intimatepartnerviolence/index.html>


Diskutimi

Pas prezantimit të nxënësve, mësuesi/ja mund të eksplorojë pyetjet e mëposhtme me klasën:

Çfarë është, sipas mendimit tuaj, Dhuna në Marrëdhëniet intime? Si mund të shfaqet ajo?

Jeni ndjerë ndonjëherë të pa respektuar në inimitetin tuaj nga ndonje shok/shoqe, i dashuri ose e dashura juaj? Si jeni ndjerë? Çfarë keni bërë? Pse morët atë vendim?

Sipas mendimit tuaj, është e lehtë apo e vështirë të thuash jo në situatë të ngjashme? Pse? Po përsa i përket respektimit të vendimit të tjetrit, si e konsideroni, të lehtë apo të vështirë? Pse?



Të Jesh në Gjendje të Respektosh Një Jo

Fleta mbështetëse e Mësuesit

Eksplorimi i Dilemave

Sinqeriteti *kundrejt* Respektit për të tjerët

Petri ishte i pavendosur nëse duhej të respektonte një "jo" nga një vajzë, apo të përpiqej ta bindte atë se do të ishte mirë që të dy të dilnin së bashku, pasi kjo ishte edhe dëshira e tij.

Ndoshta duke qenë i sqeritë për ndjenjat e tij ndaj saj dhe për ta njohur atë më mirë, ajo mund të ndryshonte mendim. Por, vullneti i saj, pavarësisht nga arsyeja, duhet të respektohet.


E drejta për të thënë "jo" *kundrejt* Detyrimit

Petri është i pavendosur nëse duhet ta detyronte një vajzë të dale me të, edhe pse ajo do thoshte "jo". Kolegët e tij thonë se vajzat thonë "jo", por thellë brenda tyre ato nënkuptojnë "po". Janë vajzat vërtet kështu? Nëse ai e detyron vajzën të dalë me të, ndoshta asaj do t'i pëlqejë dhe do të dojë të rrijë më shpesh me të. Por, ajo ka të drejtë të thotë "jo", askush nuk duhet të prekë një person tjetër, kur ajo/ai nuk dëshiron. Ai nuk do të donte që dikush ta bënte këtë gjë me të. Vajza mund të jetë e sqeritë kur thotë "jo".

Afatshkurtër *kundrejt* Afatgjatë

Nëse Petri e detyron vajzën të dalë me të, ndoshta ai do të kënaqej për momentin. Ndoshta edhe vajza do ta pëlqente këtë gjë ose jo! Por, nëse përgjigja "jo" e vajzës ishte e sqeritë, Petri do të humbiste respektin e saj dhe ajo ndoshta nuk do të donte më të ishte mikja e tij ose të fliste me të.

Nëse ai e respekton atë tani duke mos e ndjekur dëshirën e tij, ata mund të dalin më shpesh, për t'u njohur më mire me njëri tjetrin duke e forcuar më shumë miqësinë e tyre.



Të Jesh në Gjendje të Respektosh Një Jo

Fleta e nxënësit

Ngjarja

Petri po dëgjonte bisedën e disa kolegeve më të vjetër që ishin ulur pranë tij në kafene. Ata filuan të qeshnin shumë kur njëri prej tyre po u tregonte se kishte shkuar në kinema me Katerinën kur ishin në klasën e 9-të dhe më pas e kishte detyruar atë që të dilnin së bashku. Të tjerët e panë me shumë admirim dhe e pyetën:

- Ajo nuk donte?

Dhe "heroi" u përgjigj:

- Ajo tha jo, më kërkoi ta lija rehat, por më pas i pëlqeu.

Të tjerët qeshën. Njëri prej tyre, i cili kishte qëndruar pa folur, e pyeti:

- Si e di ti që asaj i pëlqeu?

Të gjithë ndaluan së qeshuri dhe e panë me një shprehje sikur do ta rrihnin:

- Je gjë budalla? Nëse ai thotë se i pëlqeu, do të thotë se asaj vërtet i pëlqeu, sepse më vonë ajo donte të dilte me të - tha njëri prej tyre.

- Sigurisht, vajzat gjithmonë thonë "jo", por vetëm për t'u bërë të vështira ... - shtoi "heroi".

Petri u zhyt në mendime. A janë vajzat vërtet kështu? Po sikur vajzat t'i thoshin "Jo" atij kur të rritej, por në të njëjtën kohë nënkuptojnë që duan të dalin?

1. Sipas mendimit tuaj, çfarë është e drejtë, e gabuar ose as e drejtë as e gabuar në këtë histori? Justifikoni përgjigjet tuaja.

Është e drejtë _____,

sepse _____.

Është e gabuar _____,

sepse _____.

Nuk është as e drejtë as e gabuar _____,


sepse _____.

2. Imagjinoni që Petri shkoi në kinema me një shoqe dhe përballet me një përgjigje "jo" kur i kërkon asaj që të dalin më shpesh së bashku.

2.1 Cilat vlera janë në konflikt në këtë situatë? Zgjidh përgjigjet e sakta:

- Drejtësia kd. Besnikërisë
- Sinqeriteti kd. Respektit për të tjerët
- E drejta për të thënë "jo" kd. Detyrimit
- E vërteta kd. Gënjeshtërisë
- Miqësia vs. Kënaqësisë së menjëhershme

2.2 Justifiko zgjedhjet e tua.



Të Jesh në Gjendje të Respektosh Një Jo

Fleta e nxënësit (vazhdimi)

3. Sipas mendimit tënd, çfarë mund të ndodhë nëse Petri:

Nuk pranon vendimin e shoqes së tij dhe e detyron atë që të dalin së bashku

Respekton vendimin e shoqes së tij për të mos dalë me të _____

4. Nëse Petri do ta vendoste veten “në rolin e një tjetri”, çfarë do të bënte ai:

Nëse Petri do të ishte një shok, ai _____

Nëse do të ishte një nga kolegët e tij, Petri _____

5. Duke u bazuar në përgjigjet tuaja të mësipërme, shkruani një tekst të shkurtër se si duhet të reagojë Petri.

